

# **KALIBRIMI DHE TESTIMI I MODELIT FAO AQUA-CROP NË KUSHTET KLIMATIKE TË ZONËS SË KORÇËS**

**Marsela Bitri<sup>1</sup>, Spiro Grazhdani<sup>2</sup>**

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Pyjore, Tiranë

## **Abstact**

Modelet njehsuese që e vlerësojnë nga ana sasiore ndikimin e ujit mbi rendimentin e kulturave bujqësore në nivel ferme, janë një mjet i frytshëm për menaxhimin e ujit dhe të ujitjes. Për të vlerësuar këtë nevojë, FAO ka zhvilluar një model që lidh reagimin e rendimentit të bimeve bujqësore ndaj ujit të përvehtësuar, i quajtur Aqua-crop, i cili simulon në mënyrë të kënaqshme rendimentin e bimëve. Ky model i jepet një vëmendje të veçantë proceseve themelore, nga një këndvështrim fiziologjik dhe agronomik, që ndikojnë në produktivitetin e bimëve bujqësore dhe në nevojat e tyre për ujë. Kërkesa për një numër të vogël parametrash të nevojshëm për funksionimin e modelit, e bën atë lehtësisht të përdorshëm dhe me një shkallë saktësie të kënaqshme në njehsime. Në këtë studim, modeli FAO aqua-crop është kalibruar dhe testuar për bimën e misrit në një regjim ujitje 100% dhe të një regjimi tjetër deficitit uji, që shkon nga 33%-50%. Modeli është në gjendje të njehsojë përdorimin e ujit edhe për raste të një evapotranspirimi shumë të lartë dhe për kushte të ndryshme të erës. Për më tepër, modeli jep të dhëna të kënaqshme për rritjen e biomasës mbitokësore, për rendimentin dhe mbulesën bimore, në kushtet kur nuk ka mungesë uji dhe në kushte mesatare furnizimi me ujë, por është më pak efikas për njehsime kur ka mungesë të ujit, sidomos kur kjo mungesë ndodh gjatë sezonit të vonshëm.